

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.K., nga fshati K. Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës “TRAINKOS” Sh.a. me seli në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson e autorizuar K.Th. juriste pranë të paditurës, për shkak të kontestit të punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.150/13 të datës 23.04.2014, në seancën jo publike të mbajtur me datë 09.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET ankesa e të paditurës NP Hekurudhat e Kosovës “TRAINKOS” Sh.a. me seli në Fushë Kosovë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.150/13 i datës 23.04.2014 ashtu që vendoset: REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit E.K., nga fshati K. Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet njoftimi nr.90 i datës 07.02.2001 i të paditurës Hekurudhat e Kosovës, me të cilin paditësi është larguar nga marrëdhënia e punës si i kundërligjshëm dhe Detyrohet e paditura Hekurudhat e Kosovës “TRAINKOS” sh.a., nga Fushë Kosova si pasardhës juridik i Hekurudhave të Kosovës, që t’ia kompensoj paditësit fitimin e humbur, në emër të pagave të pa paguara në punë dhe detyra të arkatarit, duke filluar nga data 27.02.2001 e deri më 31.08.2010 dhe atë: pagat neto të pa realizuara, në shumë prej 23.566,44 €, që së bashku me kamatën të llogaritur sipas arritjeve mujore për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë më 26.06.2001 e deri në ditën e kryerjes së ekspertizës me 31.12.2013, me normë vjetore sikurse në mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar prej 3,5 % që bëjnë shumën prej 7.274,34 €, arrin vlerën e gjithmbarshme prej 30.840,58 €; në emër të kontributit pensional në këto paga shuma prej 2,142,50 €, që së bashku me kamatën prej 27.08.2011, kur paditësi me detyrim ligjor është pensionuar të cilin kontribut si kursim pensional ka mundur të tërheq në tërësi nga Trusti i kursimeve pensionale të Kosovës e deri me 31.12.2013, shuma prej 192.42 € arrin vlerën prej gjithsej 2,334,92 €; të paguaj kamatën ligjore në shkallë prej 8 % në shumën e përgjithshme prej 33.175,70 €, duke filluar prej datës 01.01.2014, e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe të detyrohet e paditura që t’ia paguaj paditësit edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1.255,60 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm, SI E PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e atakuar C.nr. 150/2013 të datës 23.04.2014, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit E.K., në mënyrë si vijon: anulohet njoftimi nr. 90 i datës 07.02.2001 i paditurës Hekurudhat e Kosovës, me të cilin paditësi është larguar nga marrëdhënia e punës si i kundërligjshëm dhe Detyrohet e paditura Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” sh.a., nga Fushë Kosova si pasardhës juridik i Hekurudhave të Kosovës, që t’ia kompensoj paditësit fitimin e humbur në emër të pagave të pa paguara në punë dhe detyra të arkatarit, duke filluar nga data 27.02.2001 e deri më 31.08.2010 dhe atë:

Pagat neto të pa realizuara, në shumë prej 23.566,44 €, që së bashku me kamatën të llogaritur sipas arritjeve mujore për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë më 26.06.2001 e deri në ditën e kryerjes së ekspertizës më 31.12.2013, me normë vjetore sikurse në mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar prej 3,5 % që bëjnë shumën prej 7.274,34 €, arrin vlerën e gjithmbarshme prej 30.840,58 €;

Në emër të kontributit pensional në këto paga shuma prej 2,142,50 €, që së bashku me kamatën prej 27.08.2011, kur paditësi me detyrim ligjor është pensionuar të cilin kontribut si kursim pensional ka mundur ta tërheq në tërësi nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës e deri më 31.12.2013, shuma prej 192.42 € arrin vlerën prej gjithsejtë 2,334,92 €;

Të paguaj kamatën ligjore në shkallë prej 8 % në shumën e përgjithshme prej 33.175,70 €, duke filluar prej datës 01.01.2014, e deri në ditën e pagesës definitive.

Me të njëjtin aktgjykim detyrohet e paditura që t'ia paguaj paditësit edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1.255,60 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të anulohet si i kundërligjshëm dhe i pa bazuar në tërësi dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ankesën e të paditurës ta refuzoi si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe të atyre të përgjigjes në ankesë, lidhur me aktgjykimin e atakuar, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 201 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: në procedurën e rigjykimit, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, ka ngelur pranë padisë dhe kërkesë padisë dhe parashtrësës të dorëzuar në gjykatë me dt. 02.09.2013 me të cilën e ka bërë precizimin e kërkesë padisë, për shkak të rrethanave të ndryshuara. Pas zbatimit të provave në plotësim të procedurës së provave, ka propozuar caktimin e ekspertit financiar të aktuaristikës, ndërsa pas pranimit të ekspertizës e ka precizuar kërkesëpadinë. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi ka dëshmuar se ka qenë i punësuar në hekurudha që nga viti 1970, ndërsa në Stacionin Hekurudhor në Xërxe që nga viti 1972, në punë dhe detyra të punës të komercialistit të transportit - arkatar i Stacionit Hekurudhor në Xërxe. Ish Ndërmarrja hekurudhore "Beograd" JŽTP e cila kishte integruar dhunshëm Hekurudhat e Kosovës në vitet 90-ta me Aktvendimin 47/98-1319 të dt. 06.07.1998 e kishte larguar paditësin nga puna, i cili aktvendim nuk i është dorëzuar paditësit. Në vërtetimin e lëshuar nga Hekurudhat e Kosovës, dhe në regjistrimin e përvojës në librezën e punës, edhe kjo kohë e largimit ishte pranuar si përvojë e punës. Me Memorandumin e Mirëkuptimit për ri integrim në Ndërmarrjen e Transportit Hekurudhor të datës 24.08.1999, të gjithë punëtorët e larguar pas vitit 1989 dhe ata në vitin 1999, kishin statusin e punëtorit në Ndërmarrjen Hekurudhore të re. Me këtë Memorandum, janë eliminuar pasojat e veprimeve diskriminuese që ishin dhënë ndaj kësaj Ndërmarrje.

Pas përfundimit të luftës, paditësi lajmërohet në vendin e punës në Stacionin Hekurudhor në Xërxë. Ndërkaq, kur ka marrë dijeni për njoftimin nr. 90 të datës 07.02.2001 dhe për instruksionin administrativ të Departamentit të Transportit dhe të Infrastrukturës nr. 2001/3 të datës 28.02.2001, ka ushtruar ankesë kolektive Bordit të Hekurudhave të Kosovës me datën 08.05.2001 dhe meqë nuk ka marrë përgjigje ka ushtruar më pas padi në gjykatë duke kërkuar anulimin e njoftimit nr. 90 të datës 07.02.2001, të paditurës Hekurudhat e Kosovës me detaje të tjera të përshkruara si në kërkesëpadinë e precizuar të paditësit. Sipas shkresave të lëndës rezulton se e paditura, paditësin e ka kthyer në punë duke filluar nga data 01.09.2010, ku ka punuar deri në ditën e pensionimit, ndërkaq, me rastin e largimit të paditësit nga puna, e paditura nuk ka zhvilluar procedurë ligjore për largimin e tij dhe nuk i ka dorëzuar aktvendimin për largim e as nuk është udhëzuar për të drejtën në mjetin juridik.

Përfaqësuesja e të paditurës e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke ngelur në tërësi pranë parashtrësës së saj dhe bazuar në pretendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka propozuar që të konstatohet statusi i paditësit si punëtor, a ka qenë paditësi i punësuar, a ka qenë i sistemuar në vendin e punës me vendimin e ndërmarrjes së paditur, apo punonte me kontratë. Ndërsa sipas të paditurës, paditësi tek e paditura nuk ka qenë i sistemuar në asnjë vend të punës. Hekurudhat e Kosovës janë ndarë në dy kompani publike. Gjithashtu, ka theksuar se bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.102/2010 të datës 14.07.2010, paditësi është caktuar në vendin e punës depoist të vagonëve, me Kontratën nr. 0823 të datës 31.08.2010, mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës e ka kthyer lëndën në rigjykim. Po ashtu, ka cekur edhe faktin se, Hekurudha e Kosovës Fushë Kosovë-Prizren nuk ka funksionuar. Ndërkaq, lidhur me çështjen e statusit të paditësit, barra e prezantimit të dëshmitë për statusin e tij, siç ka sugjeruar Gjykata Supreme e Kosovës, qëndron tek paditësi i cili nuk ka prezantuar asnjë dëshmi gjatë procesit gjyqësor. Në anën tjetër, e paditura e ka argumentuar faktin se paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në bazë të vendimit nr. 47/981319 të datës 07.07.1998, fakt i cili është vërtetuar nga librezja e punës, ku përvoja e punës i është llogaritur prej datës 06.11.1970 e deri më 11.05.1998, në vendin e punës arkatar i mallrave, në Stacionin Hekurudhor Xërxë, ndërsa në periudhën e pasluftës kur nuk ka filluar afarizmi i Hekurudhave të Kosovës me datën 24.08.1999, paditësi nuk ka qenë i sistemuar fare në ndonjë vend të punës, sepse vendi i punës ku ka punuar paditësi deri më 06.07.1999, si arkatar i mallrave në Xërxë, në periudhën e pasluftës ky vend nuk ka ekzistuar, sepse linja hekurudhore Fushë Kosovë-Xërxë, nuk ka funksionuar për shkak të shkatërrimit të kësaj linje nga pasojat e luftës. Sikurse paditësi të kishte qenë i sistemuar në periudhën e pasluftës, prej dt 24.08.1999 deri me 01.03.2001, atëherë në librezë do të figuronte vula që ka qenë në përdorim sipas emërimit të subjektit, e jo vula e Hekurudhave të Kosovës sh.a, e cila vulë nuk është përdorur në periudhën kontestuese prej 24.08.199 e deri me 23.12.2005. Me Aktvendimin nr. 05/110 të dt. 26.02.2010 Hekurudhat e Kosovës sh.a ndahen në dy kompani "Trainkos" dhe Sh.a. "Infrakos". Në njoftimin nr. 90 të dt. 07.02.2001 paditësi në afatin ligjor nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës, ndërsa pas kalimit të afatit ligjor kundër këtij njoftimi, paditësi ka ushtruar ankesë me nr. 529 të dt. 08.05.2001 dhe nga e paditura nuk ka marrë përgjigje, kurse padinë në gjykatë e ka paraqitur me 20.06.2001, pra jashtë afatit të paraparë me ligj. Sipas përfaqësuesit të paditurës ceket se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv, në këtë çështje kontestimore. Ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre në procedurën e ripërsëritur, ka vërtetuar gjendjen faktike se, nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë i punësuar në Hekurudha që nga viti 1970, ndërsa në Stacionin Hekurudhor në Xërxë nga viti 1972 dhe atë në vendin e punës komercialist i transportit-arkatar.

Nga Aktvendimi nr.47/98-1319 i datës 06.07.1998, vërtetohet se, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Ndërmarrjen publike transportuese hekurudhore “Beograd”, mirëpo për shkak të pa mundësisë, aktvendimi nuk i është dërguar, ky fakt është konstatuar në aktvendimin në fjalë, i cili është shpallur në tabelën e publikimit në Fushë Kosovë më datën 11.08.1998. Në Memorandumin për mirëkuptim për reintegrimin e ndërmarrjes së transportit Hekurudhor të datës 28.08.1999 është konstatuar se caku përfundimtar është integrimi i plotë i të gjithë punëtorëve të mëparshëm të Ndërmarrjes së Transportit Hekurudhor, shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës dhe grupeve tjera (duke përfshirë punëtorët që kanë punuar deri më 24.03.1999 dhe ata punëtor që kanë punuar më parë deri më 1989 dhe nuk do të ketë asnjë racionalizëm shpërndarje ose ulje të pozitive në nivel më të ulët, derisa të gjithë punëtorët të kthehen në punë.

Pas njoftimit nr. 90 të datës 07.02.2001, për largimin nga puna të paditësit, i njëjti ka ushtruar ankesë kolektive Bordit të Hekurudhave të Kosovës. Me vërtetimin nr. 6/225 të datës 23.08.2011, është vërtetuar se paditësi ka qenë punëtor i Hekurudhave të Kosovës nga data 06.11.1970 deri me 05.06.2011. Paditësi është kthyer në punë nga data 01.09.2010 gjer në vitin e pensionimit. Në fund të njoftimit nr. 90 të datës 07.02.2001, është konstatuar se obligohen të gjithë shefat e reparteve të i njoftojnë punëtorët dhe t’i përgatisin vendimet përkatëse. Paditësit nuk i është dorëzuar kurrfarë vendimi. Gjykata e shkallës së parë konsideron se një veprim i tillë i të paditurës nuk ka bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sepse kjo është rregulluar me dispozitën e nenit 21 të Ligjit Themelor të Punës. Gjykata e shkallës së parë, më rastin e vendosjes ka gjetur mbështetje në dispozitën e nenit 30 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 12/89) i cili ligj është i aplikueshëm dhe ku përcaktohet se, për punën e punëtorit të cilit i pushon nevoja për punë nuk mund të largohet nga puna, por, duhet të sistemohet në vend tjetër të punës, sipas aftësive të tij profesionale të fituara në punë. Pastaj, sipas nenit 127 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të Kosovës përcaktohet se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, punëtorit duhet t’i lëshohet vendimi përkatës juridik në mënyrë që i njëjti të ketë mundësi të realizoj të drejtat e tij para organeve kompetente. Në fund gjykata e shkallës së parë bazuar në dispozitat e neneve të sipër cekura si dhe praktikën e Gjykatës Supreme të Kosovës në Vendimet Rev.nr. 46/2013, Rev.nr. 50/2013 dhe Rev.nr. 53/2013 ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i gabuar pavarësisht se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduar, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 21 të Ligjit Themelor të Punës, nenit 30 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të Kosovës (Gazeta Zyrtare “ nr. 12/89) si dhe nenit 127 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të Kosovës, të cilat i ka përdorë si bazë që ta aprovojë si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin nr.90 të dt. 07.02.2001, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoi fitimin e humbur në emër të pagave të pa paguara në punë dhe detyra të punës të arkatarit, duke filluar nga datat 27.02.2001 e deri me dt. 31.08.2010. Pastaj pagat neto të pa realizuara me kumatën prej 3,5 % në shumën e gjithmbarshme prej 30.840,58 €, kontributin pensional në këto paga, si dhe shpenzimet e procedurës, me detaje tjera të përshkruara më gjerësisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit një qëndrim dhe përfundim të tillë e gjen si të gabuar, sepse gjykata e shkallës së parë si fakt vendimtar për të gjetur si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit, e ka vlerësuar Memorandumin për mirëkuptim për reintegrimin e ndërmarrjes së transportit hekurudhor të datës 28.08.1999, vërtetimin e të paditurës nr. 111 të datës 15.02.2001, pastaj vërtetimin nr. 6/225 të datës 23.08.2011, se paditësi është kthyer në punë nga data 01.09.2010 e gjerë në ditën e pensionimit. Nga kjo rezulton se paditësi nuk provë valide se para datës 01.09.2010 ka qenë në marrëdhënie pune, fjala është për periudhën e pas vitit 1998.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, sepse në rastin konkret nuk kemi përjashtim të paditësit nga puna dhe nuk ka vendim se paditësi ka punuar në ndonjë punë të caktuar, e aq më pak në punët dhe detyrat e arkatarit, për të cilat gjykata e shkallës së parë bazuar në ekspertizën e aktuaristikës, ia ka njohur paditësit fitimin e humbur me detaje të tjera si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Kur shikohen shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara, konstatohet se paditësi ka qenë i punësuar në hekurudha që nga viti 1970, ndërsa në Stacionin Hekurudhor në Xërxë, ka punuar nga viti 1972 në vendin e punës komercialist i transportit - arkatar. Të njëjtit me Aktvendimin nr. 47/98-1319 të datës 06.07.1998 i është ndërprerë marrëdhënia e punës, aktvendimi i tillë nuk i është dorëzuar, por i njëjti është shpallur në tabelën e shpalljeve në Fushë Kosovë me datën 11.08.1998. Me njoftimin nr. 90 të datës 07.02.2001, janë njoftuar punëtorët e të gjitha reparteve të Hekurudhave të Kosovës të cilët janë të sistemuar apo gjenden në regjistrin e asistencës e të cilët gjerë në fund të vitit 2001 i mbushin 60 vjet vjetërsi apo 35 vite stazh të punës do të kompensohen duke filluar nga 01.01.2001 për punëtorët e asistencës, kurse për punëtorët e sistemuar nga data 01.02.2001, detaje tjera si në njoftimin në fjalë. Ndërkaq, po në këtë njoftim, është përcaktuar se do të organizohet një kurs për riaftësimin e tyre për punë tjera, në bashkëpunim me Organizatën e IOM-it, detaje tjera si në njoftimin në fjalë. Mirëpo, në rastin konkret, paditësi siç rezulton nga shkresat e lëndës, nuk ka ofruar ndonjë provë se i njëjti është paraqitur apo ka pranuar që të riaftësohet në Organizatën e IOM-it, dhe po ashtu i njëjti nuk ka ofruar ndonjë provë se ka qenë punëtor i të paditurës në atë kohë.

Është fakt notor se, linja hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Xërxë-Prizren, nuk ka funksionuar në kohën për të cilën paditësi kërkon kompensim, pra, i njëjti nuk ka mund edhe të sistemohet në vendin e punës arkatar, sepse i njëjti nuk ka qenë i sistemuar me ndonjë vendim valid të punës, në asnjë vend tjetër të punës. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit edhe kompensimi i kërkuar për periudhën kontestuese të cilën e kërkon paditësi, nuk ka mbështetje ligjore, sepse i njëjti paraprakisht nuk ka qenë i sistemuar në ndonjë vend të punës dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka marr pjesë në krijimin e të ardhurave personale. Prandaj në rastin konkret baza juridike e kërkesë padisë, nuk ekziston.

Gjykata e Apelit, konstaton se e paditura me rastin e njoftimit të përgjithshëm për repartet e Hekurudhave të Kosovës, kjo ka vlejte për të gjithë punëtorët të cilët kanë qenë të sistemuar apo në regjistrin e asistencës, ndërsa paditësi nuk është në ndonjërin prej këtyre dy mundësive.

Prandaj, është e pa qëndrueshme kur gjykata e shkallës së parë, siç theksohet në aktgjykimin e atakuar se bazohet edhe në praktikën e Gjykatës Supreme të Kosovës, e ndër to edhe në Aktvendimin Rev.nr.50/2013 të datës 17.07.2013, ku sipas këtij aktvendimi kemi të bëjmë me hedhjen e padisë së paditësit si të pasafatëshme, në çështjen juridike të njëjtë me paditësin, mirëpo, në situatën konkrete nuk kemi të bëjmë me pa afatshmëri të padisë, sepse gjykata e shkallës së parë, por edhe tani gjykata e shkallës së dytë, vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. E njëjta gjë vlen edhe për aktvendimin tjetër të Gjykatës Supreme, në të cilin gjykata e shkallës së parë i referohet në aktgjykimin e saj e ky është Aktvendimi Rev.nr. 46/2013 i datës 17.07.2013, në të cilin aktvendim po ashtu Gjykata Supreme ka vlerësuar afatshmërinë e padisë së paditësit, ku gjykata e shkallës së parë e ka hedhur si të pasafatshme. Situatë e njëjtë është edhe me Aktvendimin tjetër të Gjykatës Supreme Rev.nr. 53/2013, ku është vlerësuar revizioni i paditësit, ndaj aktvendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, ku padia e paditësit është hedhur si e pasafatshme dhe Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur njëjtë si në dy rastet tjera të sipër cekura. Ndërkaq, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me hedhje të padisë si të pa afatshme, por me vendosje meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Me qenë se nuk ekziston bazë për anulimin e Njoftimit nr. 90 të datës 07.02.2001, me të cilin pretendohet se paditësi është larguar nga puna, atëherë sipas Gjykatës së Apelit edhe kërkesat tjera të paditësit si: për fitimin e humbur, për pagat e pa realizuara, për kontributin pensional, për kamatën dhe për shpenzimet e procedurës nuk kanë mbështetje ligjore dhe si e tillë u refuzuan nga Gjykata e Apelit.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika e) e lidhur me nenin 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 2606/14, me datë 09.02.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni d.v